



Asociacioni i Mediave të Pavarura Elektronike të Kosovës
Association of Independent Broadcast Media of Kosovo
Asociacija Nezavisnih Elektronskih Medija na Kosovu

KOMENTET E AMPEK-ut LIDHUR ME DRAFT RREGULLOREN PËR NIVELIN DHE MËNYRËN E PAGESËS SË TAKSËS VJETORE TË LICENCËS SË KPM-së

Të nderuar anëtarë të KPM-së,

Përderisa e kuptojmë se KPM ka obligim ligjor që ta rishikojë taksën e licencës në bazë vjetore, konsiderojmë se rritja e propozuar për vitin 2014 është shumë vështirë e pranueshme, ngase konsiderojmë se disa elemente shumë me rëndësi nuk janë marrë parasysh gjatë përpilimit të draft rregullores së propozuar.

Anëtarët e AMPEK-ut fuqimisht shprehin brengën për faktin se hulumtimi i tregut i bërë nga KPM, assesi nuk përkon me gjendjen faktike të tregut medial, andaj rritja e konstatuar prej 60 % të buxhetit në bazë të të hyrave nga reklama, nuk qëndron dhe është konstatim i gabuar.

Me këtë rast shprehim brengën tonë të thellë për shkak të faktit se KPM-ja nuk ia ka dalë asnjëherë deri tash të ruajë dhe nxisë zhvillimin e tregut medial në Kosovë. Për më tepër, me draft rregulloren e propozuar do t'i rrezikojë dhe dëmtojë substancialisht shërbimet mediale audiovizuale, e në veçanti ato lokale dhe rajonale dhe ato që u shërbejnë komuniteteve pakicë.

Për këtë arsye, besojmë se KPM-ja duhet ta rishqyrtojë propozimin e vet, duke u mbështetur në shënimet reale që i janë në dispozicion, duke shmangur kështu pasojat e padëshirueshme që jetësimi i këtij drafti do të mund t'i shkaktonte zhvillimit të lirisë së shprehjes dhe demokracisë në Kosovë.

Me nderime